



AKADEMIA
Profesionale E BIZNESIT

REKTORI

Rr. "Vangjel Noti" Nr.25, pranë AMC Laprakë, Tiranë, Tel:04 2454 893, mob:0674008880, Web:www.apb.edu.al, Email: info@apb.edu.al

Nr. 3...prot.

Tiranë, më 09.12.2018

Drejtuar: Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë
Drejtorisë së Arsimit të Lartë

Tiranë

Lënda: Përgjigje Tuajes Nr. 12552. datë, 07.12.2017 mbi kriteret e pranimit të studentëve në "Akademinë Profesionale të Biznesit", për vitin akademik 2018-2019.

Mbështetur në kërkesat që parashtrihen nga ana e juaj, me shkresën nr.12552, datë 07.12.2017 lidhur me kriteret e pranimit të studentëve në "Akademinë Profesionale të Biznesit" Tiranë, për vitin akademik 2018-2019, Ju bëjmë me dije se:

1. Pranimi në ciklin e parë të studimeve

Fakultetet e APB, do të pranojnë studentë në programet e studimit të ciklit të parë në përputhje me përcaktimet e nenit 74, të Ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Kandidatët që pranohen duhet të kenë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave. Fakulteti i Ekonomisë në APB, me shkresën Nr. 235, datë 22.06.2017, ka dërguar në MAS, aplikimin për hapjen e një programi të ri në ciklin e parë të studimeve në programin "Informatikë biznesi" dhe parashikon të pranojë studentë në këtë program studimi.

a- Fakulteti i Ekonomisë në APB do të bëjë renditjen e studentëve fitues duke u bazuar në këto kritere shtesë për regjistrime në Bachelor:

1. Mesatarja e lëndëve të Shkollës së Mesme, bashkë me to edhe e notave të provimeve të maturës shtetore vlerësohet në masën 1- 30% të pikëve.
2. Lëndët që formojnë "Grup Lëndët", të cilat afrohen me orjentimin dhe formimin ku studenti synon të regjistrohet do të vlerësohen në masën 1- 30% të pikëve. Në këtë kategori të "Grup Lëndëve" përcaktohen:
 - a. Ekonomi → 35 %
 - b. Matematikë → 15 %
 - c. Informatikë → 25 %
 - d. Gjuhë e huaj → 25 %
3. Konkurs në formën e Intervistave me Komisioni i pranimeve në Fakultetin e Ekonomisë në APB, ku peshën kryesore do ta ketë; Njohuritë e studentit për Biznesin në përgjithësi; Shkalla e njohjes dhe e motivimit të studentit për të studiuar dhe për t'u aftësuar profesionalisht në programet që ai ka përzgjedhur pranë Fakultetit të Ekonomisë në APB. Vlerësimi do të jetë në masën 1- 40%, të pikëve.

4. Nga numri gjithësej i aplikuesve për secilin program studimi, Komisioni i pranimeve në Fakultetin e Ekonomisë në APB, mbështetur në renkimin e studentëve që fitojnë me shumë pike, do të përzgjedhë studentët që do të përfitojnë bursa abo gjysë burse.

b-Fakulteti i Drejtësisë në APB do të bëjë renditjen e studentëve fitues duke u bazuar në këto kritere shtesë për regjistrime në Bachelor:

1. Mesatarja e lëndëve të Shkollës së Mesme, bashkë me to edhe e notave të provimeve të maturës shtetore që do të vlerësohet në masën 1- 30% të pikëve.
2. Lëndët që formojnë “Grup Lëndët”, të cilat afrohen me orientimin dhe formimin ku studenti synon të regjistrohet do të vlerësohen në masën 1- 30% të pikëve. Në këtë kategori të “Grup Lëndëve” përcaktohen:
 - a. Histori → 20 %
 - b. Qytetari → 20 %
 - c. Filozofi → 20%
 - d. Gjuhë shqipe-20%
 - e. Gjuhë e huaj-20%
3. Konkurs në formën e Intervistave me Komisioni i pranimeve në Fakultetin e Drejtësisë në APB, ku peshën kryesore do ta ketë këtë; Shkalla e njohjes dhe e motivimit të studentit për të studiuar dhe për t'u aftësuar profesionalisht në programet që ai ka përzgjedhur pranë Fakultetit të Drejtësisë në APB, njohurit për biznesin në përgjithësi. Vlerësimi do të jetë në masën 1- 40%, të pikëve.
4. Nga numri gjithësej i aplikuesve për secilin program studimi, Komisioni i pranimeve në Fakultetin e Drejtësisë në APB, mbështetur në renkimin e studentëve që fitojnë me shumë pike, do të përzgjedhë studentët që do të përfitojnë bursa abo gjysë burse.

Institucioni i arsimit të lartë APB pas përzgjedhjes së kandidatëve, do të shpallë listen e kandidatëve fitues për ciklin e parë dhe do ta vejë në dispozicion të: Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR), duke zbatuar kërkesat ligjore dhe nënligjore që lidhen me këtë proces.

2. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve

Fakultetet e APB, do të pranojnë studentë në programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, në përputhje me përcaktimet e nenit 76, të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kandidatët që pranohen duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 74, të ligjit, të kenë përfunduar me sukses një program studimi të ciklit të parë në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë apo fusha të tjera të përfaqësuara dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore.

Fakulteti i Ekonomisë në APB, me shkresën Nr. 236, datë 22.06.2017, ka dërguar në MAS, kurikulat mbi riorganizimin e programve në master profesiona, ndersa me shkresën Nr.299, date 10.08.2017, ka dërguar në MAS, aplikimin për hapjen e një programi të ri për master profesional në “Komunikim Multikanal” në ciklin e dytë të studimeve dhe parashikon të pranoi student në këtë program studimor.

Institucioni i arsimit të lartë APB pas përzgjedhjes së kandidatëve, do të shpallë listen e kandidatëve fitues për ciklin e dytë dhe do ta vejë në dispozicion të: Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR), duke zbatuar kërkesat ligjore dhe nënligjore që lidhen me këtë proces.

3. Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve

Fakulteti i Ekonomisë në APB, me shkresën Nr. 237, datë 22.06.2017, ka dërguar në MAS, aplikimin për hapjen e një programi në ciklin e tretë të studimeve dhe parashikon të pranoi studentë në programin e studimit të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, në tre profile; “Administrim Biznesi”, “Administrim Publik” dhe “Menexhim Financiar” në përputhje me përcaktimet e nenit 78, të Ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kandidatët që pranohen duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 74, të ligjit, të kenë përfunduar me sukses një program studimi të ciklit të parë dhe të njohin një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të kenë përfunduar me sukses një program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për këtë cikël studimesh.

Fakulteti i Ekonomisë në APB do të bëjë renditjen e studentëve fitues duke u bazuar në këto kriteret shtesë për regjistrime në Master Ekzekutiv:


1. Mesatarja e lëndëve të ciklit të parë bachelor, vlerësohet në masën 1- 30%, të pikëve.
2. Mesatarja e lëndëve të Masterit të shkencave, vlerësohet në masën 1- 40%, të pikëve.
3. Intervista me komisionin e pranimeve në APB, ku peshën kryesore do ta ketë shkalla e motivimit e studentit për t'u aftësuar profesionalisht në programet që ai ka përzgjedhur pranë Fakultetit të Ekonomisë në APB, vlerësohet në masën 1- 30%, të pikëve.

Institucioni i arsimit të lartë “APB”, pas përzgjedhjes së kandidatëve, do të shpallë listen e kandidatëve fitues për ciklin e tretë dhe do ta vejë në dispozicion të: Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR), duke zbatuar kërkesat ligjore dhe nënligjore që lidhen me këtë proces.

Dëshirojmë të sqarojmë faktin se, do të vlerësonim shumë mirkuptimin Tuaj për licensimin e programeve të reja të dërguara nga ana jonë gjatë vitit të kaluar, me qëllim që maturatët që përfundojnë studimet në këtë vit akademik, si dhe individët që plotësojnë kriteret për studime në master profesional, maseter i shkencave apo master ekzekutiv, të kenë të drejtë që të zgjedhin këto programe në fakultetet tona, pasi APB ka marrë masa për ambiente studimi dhe dëshiron të parashikojë kuota studimi edhe për këto programe studimore.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, me konsideratë.

REKTORI I “AKADEMISË PROFESIONALE TË BIZNESIT”


Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

